



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË  
KANCELARI

Nr. 3864 prot.,

Datë 26.06.2026

**Lënda:** Njoftim mbi procedurën e “Lëvizjes paralele”.

Bazuar në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", vendimin nr. 622, datë 10.12.2020, "Për levizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", vendimin nr.20, datë 27.09.2023 i Këshillit të Gjykatës, "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 21.01.2021 "Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë", nga vakancat e krijuara Gjykata e lartë, vendosi të shpall procedurën e "Lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor", për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

1. **2 (dy)** vende vakante, në pozicionin “**specialist**“, Qendra e Dokumentacionit, kategoria ekzekutive, IV-1.

Pas përfundimit të verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët aplikues, rezultoi se asnjë prej kandidaturave nuk plotësonte kriteret e posaçme të përcaktuara në shpalljen përkatëse dhe, për pasojë, nuk u kualifikua për të vijuar në fazën e vlerësimit profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në këto kushte, procedura e “Lëvizjes paralele” konsiderohet e përfunduar pa kandidatë të kualifikuar. Për rrjedhojë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, Gjykata e Lartë do të vijojë me procedurën e “Pranimit në shërbimin civil gjyqësor” për plotësimin e pozicioneve të sipërpërmendura.

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO



Tel.: +355 4 2257304, Rruga: "Ibrahim Rugova" Tiranë.

E-mail: [supremecourt@gjykataelarte.gov.al](mailto:supremecourt@gjykataelarte.gov.al) ; [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)